

Në mëngjes, më **17.06.1998**, Živojini shkoi në Siboc/Sibovac [Obiliq/Obilić], për ta kontrolluar shtëpinë dhe ushqyer bagëtinë. Gjatë kthimit në Obiliq/Obilić, ku ishte strehuar përkohësisht, nga autobusi e nxorën pjesëtarët e UÇK-së. Të nesërmen, më 18.07.1998, trupi i tij i pajetë ishte gjetur pranë rrugës Mitrovicë/Kosovska Mitrovica – Skënderaj/Srbica, te fshati **Tërnac/Trnavce**. Në kokë i shiheshin qartazi gjurmët nga goditjet me mjet të topitur. Në trup i kishte shumë plumba të shkrepuar nga armët automatike. Živojinin e kanë varrosur në Obiliq/Obilić.

**Burimet:** deklarata O.B, FDH-13450; *Dnevnik od 17. do 23. juna 1998*, Ilustrovana politika, 27.06.1998, FDH-18837; *Teroristi muçili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>; USC GGDH, *Regjistri..*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički..*, III, 65, 905; KMKKRF, *Personat..*, FDH-10832.

## Sokol (Rushit) Aruqi

(1939, shqiptar nga Rezalla/Rezala, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, tetë fëmijë, civil)

Sokoli me bashkëshorten Zahiden dhe djemtë dhe vajzat jetonin në *Mëhallën Aruqi* në Rezallë/Rezala. Në datën **6.07.1998**, forcat serbe e sulmuan fshatin nga drejtimi i Deviçit/Deviç. Sokoli me familjarët e vet e braktisën fshatin dhe u strehuan në pyll përmbi fshat, në vendin e quajtur *Përroi i Thanës/Drenov potok*. Nga ora 12:00, ai mori vendim që të kthehej në **Rezallë/Rezala** për t'i dhënë ujë bagëtisë, që ka mbetur e mbyllur në ahur. Familjarët e kanë pritur atë ditë që të kthehej, por ai nuk erdhi. Në mbrëmje, kur forcat serbe u tërhoqën, djemtë e tij, Jashari dhe Hasani, u kthyen në fshat për ta kërkuar të atin. E gjetën trupin e pajetë të Sokolit në oborin e shtëpisë. Fytyrën e kishte me gjak, në gjoks dy plagë nga armë zjarri, ndërkaq nëpër duart të prerat dhe plagë thike. Po atë mbrëmje, e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata Z.A, FDH-14438; deklarata M.D, FDH-2748; deklarata Z.Z, FDH-14541; *Five More Killed in Three Villages of Drenica*,

pasqyra e lajmeve, KIC, 07.08.1998, FDH-29405; *46 Houses Burned in Likoc, Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 07.08.1998, FDH-29405; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

## Hana (Bejte Dervishi) Zabeli

(1915, shqiptare nga Rezalla/Rezala, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, gjashtë fëmijë)

Hana e moshuar me familjen e djalit Zeqirit jetonin në Rezallë/Rezala. Në datën **6.07.1998**, kur forcat serbe e sulmuan fshatin, Zeqiri me dy familjarë të tij të afërm e kanë braktisur fshatin dhe u strehuan në pyll, ndërkaq Hana me të rejën dhe fëmijët kanë mbetur në shtëpi. Po atë ditë, por më vonë, edhe e reja me fëmijët, së bashku me bashkëfshatarë të tjerë, shkuan dhe u strehuan në pyllin e afërt. Hana ka mbetur vetëm [**Rezallë/Rezala**]. Kur pushuan të shtënat dhe forcat serbe u tërhoqën, Zeqiri u kthye nga pylli. E ka gjetur të ëmën të vdekur në karrige në të cilën zakonisht rrinte ulur. Trupin e kishte të masakruar. Nuk ka mundur ta varroste menjëherë Hanen, sepse forcat serbe ende gjendeshin në rajon. Pas tërheqjes së tyre të tërësishtme, ai e ka varrosur të ëmën në oborin e shtëpisë. Pas dy javësh, më 30.07.1998, familjarët e kanë rivarrosur Hanen në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata Z.Z, FDH-14541; deklarata A.Ll, FDH-36713; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

## Fekë (Fejzë) Durmishi

(26.01.1952, shqiptar nga Rakinica/Rakinica, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Fekë Durmishi ka aderuar në shtabin lokal të UÇK-së në Rakinice/Rakinica më 15.04.1998. Në fillim të muajit korrik, u rrit prania e forcave serbe përreth fshatit. Për këtë arsye, ai dhe ushtarë të tjerë i zhvendosën familjet e veta në Tushilë/Tušilje. Në datën **7.07.1998**, forcat serbe i kanë sulmuar pozicionet e UÇK-së në Rakinice/Rakinica nga drejtimi i Vitakut/Vitak, Skënderajt/Srbica dhe Laushës/Lausha. Disa ushtarë u tërhoqën menjëherë,